

VENDIM
Nr. 832, datë 30.12.2025

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË
MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT TË ARSIMIT TË LARTË (SMIAL)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (në vijim SMIAL).

2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore SMIAL është Qendra e Shërbimeve Arsimore.

3. Të dhënat e bazës shtetërore ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhënat parësore të SMIAL-it konsiderohen të dhënat e mbledhura nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, që kanë të bëjnë me:

- i. të dhënat e regjistrimit të studentëve në çdo program studimi;
- ii. numrin e identifikimit të matrikullimit të studentit;
- iii. informacionin për statusin për pajisjen me numër matrikullimi;
- iv. mbështetjen financiare dhe kreditë studentore;
- v. strukturën e institucioneve të arsimit të lartë;
- vi. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve, njësive kryesore dhe bazë e të programeve të studimit;
- vii. programet e studimit me profilet e tyre, si dhe kuotat e pranimi në to;
- viii. certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për kuotat e pranimi në programet e studimit të ofruara nga IAL-të;
- ix. udhëheqjet shkencore në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”;
- x. projektstatutet dhe ndryshimet statutoe të IAL-ve;
- xi. informacione për aktet e hapjes/riorganizimit dhe akreditimit të parë e periodik të IAL-ve e të programeve të studimit;
- xii. regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave, të cilat lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë;
- xiii. pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrat themeltarë, të arritjeve akademike e të lëshimit të diplomave dhe të certifikatave;
- xiv. njohjen e njësimin e diplomave dhe të certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë;

xv. njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të huaj;

b) Të dhënat dytësore të SMIAL-it konsiderohen të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, Regjistri Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë, Regjistri Tregtar dhe nga Sistemi i Tatimit Elektronik, si më poshtë vijon:

- i. emri, atësia, amësia, mbiemri;
- ii. numri i identifikimit personal;
- iii. datëlindja, gjinia, vendlindja;
- iv. statusicivil;
- v. adresae vendbanimit;
- vi. shtetësia;
- vii. të dhënat personale të studentëve të huaj;
- viii. të dhënat NUIS/NIPT të institucioneve publike dhe jopublike të arsimit të lartë.

4. Dhënës të informacionit për SMIAL-in janë institucionet e arsimit të lartë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Sistemi SMIAL ndërvepron me:

- a) bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile;
- b) Sistemin e Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara;
- c) Regjistrin Elektronik Kombëtar për të Huajt në Republikën e Shqipërisë;
- ç) Regjistrin Tregtar dhe Sistemin e Tatimit Elektronik.

6. Institucioni administrues siguron që përpunimi i të dhënave personale në SMIAL të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar ligjshmërinë, drejtësinë, transparencën, minimizimin e të dhënave, saktësinë dhe ruajtjen e tyre, vetëm për periudhën e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar të ruajtjes, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen, sipas procedurave të miratuara nga institucioni administrues, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Niveli i aksesimit në sistemin SMIAL bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve:

a) Ministria përgjegjëse për arsimin për:

i. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve, njësive kryesore e të programeve të studimit, si lexues, konfirmues dhe përditësues;

ii. certifikimin e kapaciteteve akademike e infrastrukturore në sistem dhe kuotat e pranimit në programet e studimit të ofruara nga IAL-të, si lexues dhe konfirmues;

iii. udhëheqjet shkencore në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, si lexues dhe konfirmues;

iv. projektstatutet dhe ndryshimet statutore të IAL-ve, si lexues e konfirmues;

b) Qendra e Shërbimeve Arsimore për:

i. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve, njësive kryesore dhe bazë e të programeve të studimit, si lexues;

ii. programet e studimit me profilet e tyre, si dhe kuotat e pranimit në to, si lexues;

iii. të dhënat e regjistrimit të studentëve në çdo program studimi, si lexues dhe konfirmues;

iv. gjenerimin, numrin e identifikimit të matrikullimit të studentit, si krijues;

v. certifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për kuotat e pranimit në programet e studimit të ofruara nga IAL-të, si lexues;

vi. udhëheqjet shkencore në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, si lexues;

vii. regjistrimin e formave të diplomave dhe të certifikatave, të cilat lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë, si lexues e konfirmues;

viii. pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrat themeltarë, të arritjeve akademike e të lëshimit të diplomave dhe certifikatave, si lexues dhe konfirmues;

ix. njohjen e njësimit të diplomave e të certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, si lexues dhe konfirmues;

x. njohjen e titujve akademikë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të huaj, si lexues dhe konfirmues;

c) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për:

i. hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve, njësive kryesore dhe bazë e të programeve të studimit, si lexues;

ii. të dhënat për akreditimin e parë të IAL-ve e të programeve të studimit, si lexues dhe përditësues;

iii. të dhënat për akreditimin periodik të IAL-ve e të programeve të studimit, si lexues dhe përditësues.

ç) Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për:

i. të dhënat për mbështetjen financiare të studentëve, si lexues dhe konfirmues;

- ii. të dhënat për kreditë studentore, si lexues dhe konfirmues;
 - d) Institucioni i arsimit të lartë për:
 - i. të dhënat për strukturën organizative të institucioneve të arsimit të lartë, njësitë, programet e studimit dhe profilet e tyre, si krijues;
 - ii. projektstatutet dhe ndryshimet statutores të IAL-ve, si krijues e përditësues;
 - iii. kuotat dhe rialokimet e tyre, në bazë të certifikimit të tyre nga ministria përgjegjëse për arsimin, për çdo program studimi dhe profil, si krijues;
 - iv. të dhënat për regjistrimin, transferimin, pezullimin, çregjistrimin e diplomimin e studentëve, si krijues dhe përditësues;
 - v. të dhënat estudentëve për pajisjen me numër matricullimi, si krijues dhe përditësues;
 - vi. mbështetjen financiare dhe kredinë studentore, si krijues dhe përditësues;
 - vii. regjistrimin e formave të diplomave e të certifikatave, të cilat lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë, si krijues dhe përditësues;
 - viii. pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrat themeltarë të arritjeve akademike dhe të lëshimit të diplomave e të certifikatave, si krijues dhe përditësues.
 - 8. Organizimi e funksionimi i brendshëm i sistemit dhe i bazës së të dhënave të SMIAL-it përcaktohen e miratohen me rregullore të brendshme të institucionit administrues, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.
 - 9. Palët zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, për çdo veprim në regjistër lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave personale, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve e të shërbimeve të përpunimit.
 - 10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama